



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 22.14.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIAR VJETORE TË KOMUNËS SË**  
**PRIZRENIT**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi , i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Kapllan Muhaxheri (Udhëheqës i ekipit) si dhe Alban Beka dhe Arian Zenelaj (Anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Luljeta Morina.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	30
5 Qeverisja e mirë.....	31
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	34
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	37
Shtojca III: Letër konfirmim .....	46

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Prizrenit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 29/09/2017. Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Prizrenit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjës

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksim i Çështjës**

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe subvencione në vlerë 1,651,787€, ishin buxhetuar, realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Shpalosjet në pasqyrat financiare nuk janë prezantuar drejtë. Kartela e llogarive të arkëtueshme për menaxhimin e mbeturinave, si dhe obligimet e papaguara në pasqyrat financiare ishin të nënvlerësuar për 184,921€, përkatësisht 334,518€. Po ashtu edhe pasuritë jo-financiare me vlerë mbi 1,000€ ishin të shpalosura me gabime.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Prizrenit. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme, e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe subvencione në vlerë 1,651,787€, ishin buxhetuar, realizuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Këto mjete ishin shpenzuar kryesisht për kontratat: Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave; Fshirja dhe larja e rrugëve; Furnizimi i fermerëve me foli plastike; Sigurimi fizik i objektit; Transportimi i mësimdhënësve; Eliminimi dhe vaksinimi i qeneve endacak etj. Sipas komunës keq-klasifikimet janë pasojë e buxhetit të kufizuar për mallra dhe shërbime e të cilat janë të domosdoshme, andaj edhe janë aprovuar me ligjin e buxhetit. Pavarësisht arsyetimeve të prezantuara, sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik këto shpenzime nuk plotësojnë kriteret për tu trajtuar si kapitale;
- Komuna nuk ka harmonizuar saldot përfundimtare të kartelës së llogarive të arkëtueshme për menaxhimin e mbeturinave, me saldot fillestare, andaj në PFV, kjo llogari ishte e nënvlerësuar për 184,921€<sup>1</sup>. Komuna nuk ka arritur të na ofroj dëshmi për të arsyetuar diferencën e paraqitur;
- Obligimet e vitit 2017 në vlerë 334,518€<sup>2</sup> të paguara në muajin shkurt 2018, nuk ishin shpalosur si obligime të papaguara në PFV, të neni 17 "Pasqyra e detyrimeve (faturat) e papaguara" për vitin 2017; dhe
- Pasuritë jo-financiare me vlerë mbi 1,000€ të shpalosura në PFV nuk kishin përfshirë 15 pagesa për investime kapitale të bëra në vitin 2017 në vlerë 268,425€<sup>3</sup>. Në anën tjetër në regjistrin kontabël dhe në PFV ishin përfshirë edhe pagesa për ndëshkime (penale) në vlerë 593,290€ të cilat nuk përmbushin kushtin të trajtohen si investime kapitale.

## Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

- Komuna e Prizrenit ka prezantuar gjendjen e llogarive të arkëtueshme (LLA) prej 17,063,000€. Në këtë shumë përfshihen të arkëtueshme të vjetërsuara prej shumë vitesh të taksave për leje afariste në vlerë prej 6,3 mil.€ ku mundësia e inkasimit të tyre është

<sup>1</sup> Saldo fillestare e të arkëtueshmeve ishte 1,859,000€, kur i shtohet faturimet e vitit 2017 në vlerë 1,785,857€ si dhe zbritën arkëtimet e vitit 2017 në vlerë 1,118,936€, saldo përfundimtare e tyre duhej të jetë në vlerë 2,525,921€, derisa komuna ka paraqitur vlerën 2,341,000€, duke nënvlerësuar vlerën e të arkëtueshmeve për 184,921€.

<sup>2</sup> Pagesat nr. 62218010 neni 39.2 në vlerë 137,974€; Nr. 622180034 Intervenimi në infrastrukture në raste fatkeqësie natyrore në vlerë 77,113€, si dhe Nr. 622180034 Intervenimet në infrastrukture në raste fatkeqësie natyrore 129,431€.

<sup>3</sup> Ndërtimi i rrugëve në fshatin Krushë e vogël në vlerë 11,625€; Ujësjellësi shtimi i kapacitetet të ujit në Prizren në vlerë 57,682€; Ndërtimi i rrugëve në vlerë 5,310€; Kanalizimi në fshatin Mazrek në vlerë 20,000€; Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Mazrek-faza II në vlerë 13,044€; Ndërtimi rrugë lokale dhe kanalizimi në Tusuz në Prizren në vlerë 22,477€; Ndërtesat e banimit në vlerë 10,000€; Ndërtesa e banimit (Mirëqenie sociale) në vlerë 20,000€; Në Kalanë e "Gralishtës" në Korishë Prizren në vlerë 4,600€; Ndërtimi i rrugës interne në lagjen Tusuz në vlerë 7,700€; Ndërtimi i Tribunave të stadiumit të qytetit në Prizren në vlerë 61,740€; Pajisje tjera në vlerë 9,695€; Pajisje speciale mjekësore në vlerë 11,800€; Pajisje tjera në vlerë 7,750€; si dhe Pajisje tjera për sektorin e Emergjencës në vlerë 5,000€.



minimale. Po ashtu dhe të arkëtueshmet nga mbeturinat dhe tatimi në pronë përbejnë 48% të të hyrave të komunës;

- Gjatë vitit 2017 komuna është paditur për shuma të konsiderueshme të obligimeve, ku mbi 2 mil. € janë kryer pagesa direkt nga thesari dhe përmes vendimeve gjyqësore; dhe
- Komuna ka një rritje të obligimeve të pa paguara prej 1.9 mil. € në raport me vitin e kaluar. Për me tepër afro 3,000 lëndë janë në procese të procedurave gjyqësore. Nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të operatorëve, organizata pritet të ketë pasoja të rënda financiare.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Menaxhmenti i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 02/2013 ;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Pasqyrat Nëntë mujore me kohë; dhe
- Planin e Prokurimit për vitin 2017.

Në PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2018 ishin prezantuar disa gabime, të cilat menaxhmenti i kishte përmirësuar në PFV-të e korrigjuara të datës 19/03/2018. Më gjithë përmirësimet e bëra PFV-të ende kishin disa gabime, kryesisht për keq-klasifikimet, si dhe shpalosjet e pasurisë dhe obligimeve, të cilat i kemi prezantuar tek theksimi i çështjes të opinionit auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë dhe në opinionin e auditimit, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në këtë kontest të raportimit të jashtëm kemi vërejtur se komuna ka plotësuar kënaqshëm të gjitha kërkesat për raportim përveç, raportimit mujor të obligimeve në MF, sipas Rregullës financiare 02/2013.

## 2.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipërpërmendura jepen rekomandimet, si në vijim:

**Rekomandimi 1** Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në theksimin e çështjes të opinionit të auditimit.

Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka të dizajnuar një sistem të mirë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me të hyrat, prokurimin, si dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive në përgjithësi janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime, janë procesi i menaxhimit dhe raportimit të llogarive të arkëtueshme, detyrimeve dhe klasifikimi i shpenzimeve.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>4</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>38,656,659</b>	<b>40,187,836</b>	<b>36,765,293</b>	<b>36,983,514</b>	<b>36,316,641</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	32,554,553	31,945,647	30,869,927	30,767,839	30,671,904
Të hyrat bartura <sup>5</sup>	-	1,792,451	1,573,645	1,345,624	1,537,404
Të hyrat vetjake <sup>6</sup>	6,102,106	6,102,106	4,125,517	4,679,230	4,062,518
Donacionet e brendshme	-	199,829	83,697	84,038	28,956
Donacionet e jashtme	-	49,446	14,150	106,783	15,859
Huamarrja		98,357	98,357	-	-

<sup>4</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

<sup>5</sup> Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

<sup>6</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në krahasim me buxheti fillestar ishte rritur për 1,531,177€. Ndryshimet nga buxheti fillestar ishin, si:

- Rritja e buxhetit si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti 2016 në vlerë 1,792,451€, nga pranimi i donacioneve në vlerë 249,275€, si dhe nga fondi për huamarrje më marrëveshje me Ministrin e Shëndetësisë për regjistrimin e pacienteve të kontrolluar në vlerë 98,357€; dhe
- Në anën tjetër kursimet/ zvogëlim nga granti qeveritar në vlerë 608,906€, në bazë të vendimit të qeverisë.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final me një rritje për 3% krahasuar me vitin 2016 (88%), megjithëse sipas kategorive ekonomike nivel i ulët i realizimit ishte te investimet kapitale, te mallrat dhe shërbimet. Mjetet e pranuar nga donacionet e jashtme nuk ishin shfrytëzuar mjaftueshëm, ose vetëm 28% e tyre. Kjo për shkak se ky burim i fondeve nuk ishte marrë në konsideratë nga komuna gjatë planifikimit të buxhetit.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>38,656,659</b>	<b>40,187,836</b>	<b>36,765,293</b>	<b>36,983,514</b>	<b>36,316,641</b>
Pagat dhe Mëditjet	18,874,056	18,923,789	18,777,598	18,919,546	18,258,306
Mallrat dhe Shërbimet	3,311,386	3,434,907	2,670,957	2,807,989	2,448,555
Shërbimet komunale	1,081,200	1,081,200	869,094	762,688	751,705
Subvencionet dhe Transferet	477,615	484,281	463,438	325,767	334,608
Investimet Kapitale	14,912,402	16,263,659	13,984,206	14,167,524	14,523,467

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale në vlerë 1,351,257€, ekzekutimi ishte i ulët në 86%. Në kuadër të realizimit të buxhetit përfshihen edhe pagesat e bëra për penaltitë e paguara për shkak të vonesave në shpronësimin e tokave për “Ndërtimin e impiantit në f.sh Vlashnje” në vlerë 593,290€, si dhe obligimet e bartura nga viti 2016 në vlerë 1,454,856€;
- Buxheti final për paga dhe mëditje 18,923,789€, ishte rritur për 49,733€, ndërsa niveli i realizimit ishte në 99.5%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 123,521€, mirëpo pavarësisht kësaj niveli i realizimit ishte në 78%, e në anën tjetër obligimet në këtë kategori ishin rritur për 90,000€ (nga 63,000€ sa ishin në vitin 2016 në 153,000€ në fund të vitit 2017). Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së komunës për të planifikuar dhe menaxhuar mirë me buxhetin në dispozicion;
- Buxheti final për shërbimet komunale nuk kishte pësuar ndryshime në raport me buxhetin fillestar. Niveli i shpenzimit në kategori ishte 80%. Vlen të theksohet se obligimet në këtë

---

kategori janë zvogëluar për 26,000€ (nga 34,000€ sa ishin në vitin 2016, në vetëm 8,000€ në fund të vitit 2017); dhe

- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 6,666€, ndërsa niveli i realizimit ishte në 96.%.

---

## Çështja 2 - Nivel i ultë i realizimit të realizimi i buxhetit

**E gjetura** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ultë i tij ka rezultuar nga mangësitë në vijim:

- Ekzekutimi i buxhetit të investimet kapitale është në nivel të ultë (86%), shpenzimi nuk e arrin madje as buxhetin fillestar edhe pse kishte rritje të buxhetit final; dhe
- Ekzekutimi i buxhetit tek mallrat dhe shërbimet është në nivel të ultë (78%) dhe dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet, sepse 49% e shpenzimeve janë realizuar në tremujorin e fundit të vitit, po ashtu shpenzimi nuk e arrin madje as buxhetin fillestar.

Si pasojë e dobësive në planifikimin dhe realizimin e projekteve fondet nga të hyrat vetjake në vlerë 3,229,708€ janë bartur si të pa shpenzuara. Për më tepër, edhe përkundër suficitit obligimet e pa paguara kanë arritur në nivel domethënës (shih kapitullin 3.12).

**Rreziku** Shfrytëzimi jo mjaft efektiv i fondeve në dispozicion, do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

**Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë që përformanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin 6,617,699€, duke tejkaluar planifikimin për mbi 8%. Kjo rritje është ndikuar nga inkasimi i të hyrave të tatimit në pronë si kategori dominuese në strukturën e hyrave vetjake, lejet e ndërtimit, taksa për mbledhjen e mbeturinave, të hyrat nga qiraja, etj.

**Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	6,102,106	6,102,106	6,617,699	6,292,849	5,276,000

Të hyrat e planifikuara sipas buxhetit ishin 6,102,106€. Realizimi i të hyrave gjatë vitit ka tejkaluar parashikimet prej 515,593€ dhe kuvendi i komunës ka aprovuar të hyra shtesë. Në këtë vlerë nuk janë paraqitur edhe të hyrat indirekte, si: gjobat e trafikut 392,008€, gjobat e gjykatave 114,715€ dhe të hyrat nga ekonomia e pyjeve 11,999€.

Tejkalimi i të hyrave në raport me planifikimin në veçanti ishte rezultat i rritjes së të hyrave nga lejet e ndërtimit për 781,368€, si dhe kompensimi i pronave që janë shpronësuar për ndërtimin e autostradës Vërmicë - Merdare në vlerë 259,890€.

Të hyrat vetjake, përfshirë edhe të hyrat indirekte janë shpenzuar si në vijim: për investimet kapitale 4,276,513€, ose 75% e tyre, ndërsa pjesa tjetër në vlerë 1,422,650€ është shpenzuar në kategori tjera.

Gjatë vitit 2017 janë inkasuar të hyra nga tatimi në pronë për këtë vit dhe vitet e mëhershme 2,060,280€ (shuma prej 1,051,933€ janë arkëtime nga faturimi i vitit 2017), kurse faturimi vetëm për këtë vit ishte 2,264,609€. Komuna nuk ka aplikuar ndonjë qasje pro aktive për mbledhjen e tatimit në pronë.

### Çështja 3 – Menaxhim jo adekuat i të hyrave nga tatimi në pronë

**E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin (ri anketimin) e 1/3-tës së pronave të paluajtshme siç kërkohet me Ligjin për Tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese. Nga gjithsejtë 48,645 prona, komuna gjatë këtij viti ka arritur të verifikoj vetëm 4,540 prona ose 9.33%.

Sipas nenit 9 të Ligjit mbi tatimin në pronë, çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësisia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës. Ne kemi identifikuar pesë raste ku komuna nuk kishte vepruar në përputhje me ligjin për arsye se kishte tatimpagues që posedonin dy prona të regjistruara si banim kryesor dhe për secilën pronë është aplikuar zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës.

---

**Rreziku** Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen. Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

**Rekomandimi 3** Kryetari duhet të sigurojë se verifikimi të bëhet në baza të rregullta vjetore sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, që reflekton shënime të përditësuara të regjistrit dhe ngarkesave të sakta tatimore.

#### Çështja 4 – Parregullsi në dhënien me qira të pronave komunale

**E gjetura** Në dy raste qiramarrësit e shfrytëzojnë pronën komunale për tregje pa kontratë valide, sepse kontrata ju kishte skaduar qysh në vitin 2013, ndërsa gjatë vitit 2017 nuk janë ngarkuar nga komuna. Sipas zyrtarëve komunal të gjitha procedurat kanë përfunduar dha ka mbetur vetëm nënshkrimi i kontratave. Këta qiramarrës kanë obligime ndaj komunës në vlerë 182,476€, që krahasuar me vitin e kaluar kanë zbritur obligimet e tyre për 103,358€ (obligimet e tyre ndaj komunës në vitin 2016 ishin 285,834€), pas marrëveshjeve të arritura nga komuna dhe qiramarrësit.

Komuna kishte lidhur kontrata për shfrytëzimin e pronave komunale me çmim 1€ në muaj, për nëntë lokale për partitë politike të cilat përfaqësojnë Asamblenë Komunale. Për këto lokale nuk ishte organizuar ankand publik siç kërkohet me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale. Sipas zyrtareve komunal lokalet ishin dhënë në shfrytëzim në bazë të vendimit të asamblesë komunale të vitit 2005.

**Rreziku** Dhënia në shfrytëzim e pronave publike pa ankand publik, eliminon mundësinë e pjesëmarrjes së personave tjerë të interesuar dhe dëmton parimin e transparencës dhe konkurrencës. Ky fakt shpalos dobësi serioze në zbatimin e kontroleve të komunës për pronat e dhëna me qira. Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e kontratave të qiradhënies rezultojnë me humbje të konsiderueshme financiare për komunën dhe reduktojnë aftësinë e komunës për financimin e projekteve nga burimet vetjake.

**Rekomandimi 4** Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të inkasoj të gjitha të arkëtueshmet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj komunës, të siguroj që për të gjitha pronat publike të organizohet ankandi publik dhe të nënshkruhen kontratat sipas legjislacionit.



## Çështja 5 – Parregullsi në kalkulimin e të hyrave për tatimin në prone dhe të hyrave tjera

**E gjetura** Në një rast faturimi i tatimit në pronë për biznesin (sallë dasmash) është kalkuluar gabimisht si 728€ për vitin 2017, sipas normës tatimore 0.15%, duke aplikuar edhe zbritjen për banim 10,000€. Të hyrat nga tatimi në pronë për këtë rast janë nënvlerësuar rreth 164€ sepse komuna nuk ka aplikuar normën tatimore 0.18% dhe në këto raste sipas rregullores, nuk lejohet zbritja prej 10,000€.

Në një rast tjetër komuna ka faturuar dhe pranuar 100€ të hyra për “Regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes”, përderisa sipas rregullores për tarifa dhe ngarkesa, duhet të aplikohet ngarkesa tarifore prej 60€. Sipas zyrtarit të gjendjes civile, faturimi është bërë sipas Ligjit për gjendjen civile.

**Rreziku** Mangësitë e identifikuar rezultojnë me ngarkesa të parregullta për qytetarët dhe kjo mund të dëmtoj kredibilitetin e komunës ndaj qytetarëve. Gjithashtu tarifat e caktuara gabimisht rezultojnë me të hyra të parregullta për vet komunën.

**Rekomandimi 5** Kryetari duhet të siguroj se ngarkesa për pagesën e obligimeve të qytetarëve është duke u bërë sipas rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale. Në të kundërtën, rregullorja duhet të ndryshohet dhe plotësohet sipas tarifave të reja.

### 3.3 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 18,923,789€, ndërsa shpenzimet ishin prej 18,777,598€ apo 99%.

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar, që menaxhohet nga MF. Kontrollat kyçe duhet të konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave si aprovimi dhe futja në listë të pagave të punonjëseve, verifikimi i numrit të lejuar dhe kontrollat tjera dhe aprovimi i buxhetit për paga dhe mëditje nga asambleja komunale. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i stafit të miratuar ishte 3,101 punonjës, ndërsa numri aktual i punonjësve është 3,161. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit si dhe dosjet e personelit për të verifikuar rregullsinë e tyre.

---

### Çështja 6 - Mungesë e dosjeve të personelit

**E gjetura** Për 29 zyrtarë të cilët janë të angazhuar në Drejtorin për Emergjencë dhe Siguri, zyrtarët përgjegjës nuk ishin në gjendje të na ofrojnë dosjet e kompletuara dhe kontratat e këtyre zyrtarëve, në bazë të të cilave kryhet kompensimi i pagave. Sipas menaxherit të personelit nuk ka dokumentacion relevant për këta zyrtar, dhe kjo dukuri është shfaqur si pasojë e një memorandumit të nënshkruar vite me parë pasi që zyrtarët janë pjesë e Ministrisë të punëve të brendshme, ndërsa kompensimi i pagave dhe kompensimet e tjera kryhen nga komuna. Kjo pasqyron një mungesë të specifikave të qarta për Burimet Njerëzore që ndërlidhen me zbatimin e kërkesave të UA-ve si pjesë e përshkrimit të detyrave të tyre të punës. Për me tepër identifikua se një pjesë e listave të pagave nuk janë nënshkruar nga të punësuarit e komunës.

**Rreziku** Pagesat për zyrtarët në mungesë të dokumentacionit relevant, rezultojnë në pamundësinë për të justifikuar pagën/shtesat ose për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimet e performancës. Mos nënshkrimi i listës së pagave rritë rrezikun që gabimet e mundshme të mos identifikohen dhe shpenzimet e ndodhura për paga të mos arsyetohen.

**Rekomandimi 6** Kryetari të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e pagave të tyre. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë që listat e pagave nënshkruhen nga të gjithë të punësuarit e komunës.

### Çështja 7 - Mungesë e dëshmive për punët jashtë orarit

**E gjetura** Vlera e kompensimit për punë shtesë gjatë vitit 2017 është 20,200€. Aprovimi për orët shtesë bëhet kryesisht me arsyetimin e rritjes së vëllimit të punëve. Në tri raste zyrtarët janë paguar për orë shtesë të angazhuar gjatë vikendeve (sipas formularit nga autorizuesi i punës jashtë orarit, Seksioni B, pjesëmarrje në komisione me rastin e rekrutimit, takimet e grupeve punuese për përgatitjen e testeve), mirëpo në sistemit elektronik nuk kishte evidencë/gjurmë për të justifikuar prezencën e stafit dhe kompensimin tyre për këtë periudhë. Në bazë të informatave nga mbikëqyrësi, takimet janë mbajtur jashtë objektivit ku është vendosur sistemi elektronik i evidentimit të zyrtarëve.

---

- Rreziku** Mungesa e kontrolleve adekuate dhe dokumentimit të duhur për punët jashtë orarit mund të rezultojë me pagesa për punë që nuk janë kryer apo pagesa të dyfishta për punët që në fakt është dashur të kryhen brenda orarit të punës. Kjo ndikon në zvogëlimin e efikasitetit të punës dhe dëmton buxhetin e komunës.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj që puna jashtë orarit të planifikohet në mënyrë efektive, kompensimet për orë shtesë duhet të konsiderohen vetëm gjatë periudhave kur ka vëllim më të madh të punëve dhe puna shtesë duhet të dokumentohet dhe arsyetohet.

### 3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe komunalni në vitin 2017 ishte 4,516,107€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,540,051€ apo 78%.

#### Çështja 8 – Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta

- E gjetura** Komuna gjatë vitit 2017 kishte angazhuar 78 punonjës me kontrata për shërbime të veçanta. Pagesa për këto shërbime është bërë nga kategoria mallra dhe shërbime. Nga tetë rastet e testuara, të gjitha kontratat janë lidhur për pozita të rregullta të punës (nëpunës arkivi, tatimi në pronë, për shërbime me qytetaret, roje pyllit etj.), e jo për ekspertë të fushave përkatëse.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave të zakonshme me kontratave për shërbime të veçanta ndikon në rritjen e shpenzimeve të shërbimeve kontraktuese dhe shpenzimin e parregullt të buxhetit për këtë kategori.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Angazhimi të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes një procesi konkurrues dhe transparent dhe periudha e angazhimit të bëhet në kuadër të afateve të parapara me ligj. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

**Çështja 9 - Pagesa për mallra dhe shërbime pa procedura të prokurimit**

**E gjetura** Pagesa në vlerë 4,000€, për sigurimin e automjeteve është bërë pa procedura të prokurimit, pasi që komuna nuk ka kontratë me ndonjë Operator Ekonomik (OE) për sigurimin e automjeteve. Ligji i prokurimit publik nuk i përjashton këtë lloj të shpenzimit nga procedurat.

Në pagesën në vlerë 10,578€ për mirëmbajtjen e automjeteve, komuna ka paguar shumen prej 5,504€ për artikujt të cilat nuk janë të parashikuar në kontratë. Sipas kontratës së nënshkruar në mes komunës dhe OE, në pamundësi të përfshirjes së të gjitha pjesëve të cilat janë objekt i furnizimit dhe ndërrimit, formohet një komision nga ana e komunës për furnizimin e tyre sipas çmimeve të tregut që bije në kundërshtim me nenin 1 dhe 4 të kontratës. Gjatë testimit të pagesës nuk kemi gjetur dëshmi të formimit të komisionit por vetëm faturim nga ana e OE.

**Rreziku** Anashkalimi i procedurave të prokurimit rrezikon konkurrencën e lirë të tregut dhe transparencën në përzgjedhjen e OE. Pagesat jashtë kontratës mund të ndikojnë në humbje financiare për komunën dhe të rrezikojnë arritjen e duhur të vlerës për parane e shpenzuar.

**Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se nuk janë anashkaluar procedurat e prokurimit aty ku janë të zbatueshme si dhe me rastin e përgatitjes së kërkesave për mirëmbajtjen e automjeteve mundësisht të përfshihen të gjitha auto pjesët e nevojshëm.

### 3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 484,281€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 463,348€, ose 96%. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin për entitete publike, klube të sportit, organizatave jo qeveritare të ndryshme, shoqëri kulturo artistike etj.

**Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 16,263,660€. Prej tyre në vitin 2017 janë shpenzuar 13,984,206€, apo në shkallen prej 86%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, objekteve shkollore, etj. Në krahasim me vitin e kaluar, vërehet një ekzekutim më i dobët i buxhetit në këtë kategori për 183,318€, apo rreth 1.5%.

#### Çështja 10 – Dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave për investime kapitale

**E gjetura** Dobësitë sistematike lidhur me menaxhimin e kontratave për investimet kapitale i kemi prezantuar në vijim, si:

- Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga vitet e kaluara. Kontrata e nënshkruar në vitet e mëparshme në vlerë prej 100,000€ për vazhdimin e projektit për ndërtimin e rrugës “Tranziti i vjetër” nuk është zbatuar pasi ka probleme pronësore me pronarin e një shtëpie. Ky rast ka përfunduar në procedurë gjyqësore, dhe në këtë pozicion buxhetor janë zvogëluar mjete financiare në vlerë prej 50,000€;
- Të projekti “Rregullimi i shtratit të Lumë-bardhit” në vlerë 100,000€, komuna ka zhvilluar procedurat tenderuese, si dhe është nënshkruar kontrata, mirëpo paralelisht me këtë Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë kërkesë në Urbanizëm për lejimin e kushteve ndërtimore (lejes së ndërtimit). Si pasojë është kërkuar nga kontraktuesi të mos të fillojë punimet derisa të sigurohet leja ndërtimore;
- Të projekti “Efiqenca në ndriçimin publik” në vlerë prej 60,000€, kanë filluar procedurat në tre mujorin e fundit të vitit 2017 dhe ka pasur një ankesë në OSHP. Përkundër vendimit të OSHP-së në favor të OE ekonomik, kjo kontratë ende nuk është nënshkruar. Mjetet e buxhetuara në këtë projekt janë marrë nga departamenti i Thesarit në bazë të (neni 39.2) për kryerjen e obligimeve për OE tjerë;
- Projekti “Ndërtimi i rrugës Faradin Hoti” fillimisht ishte vlerësuar në vlerë 40,000€, mirëpo gjatë hartimit të projektit detal kostoja e këtij projekti ka dalë përafërsisht 500,000€. Menaxhmenti i drejtorisë duke e analizuar këtë disporpocion në mes planifikimit buxhetor dhe kostos reale të këtij projekti ka vendosur që mos të fillohet me procedura për këtë projekt. Po ashtu komuna nuk ka zhvilluar procedurat e prokurimit për projektet “Ndërtimi i QMF-së në fshatin Gjonaj” në vlerë 120,000€ dhe “Furnizimi me GPS për matje kadastralë” në vlerë prej 10,000€ edhe pse ishin planifikuar me planin e prokurimit;

- Në katër<sup>7</sup> raste, komuna ka lidhur kontrata publike jashtë planit vjetor të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP), dhe nuk janë ndjekur procedurat e rregullta për sigurimin e konfirmimit nga Autoriteti Qendror i Prokurimit për inicim të procedurave për projektet të cilat nuk janë të përfshira në planin e prokurimit publik. Për kontratën “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Legjendë-Malësi e Re” në kuadër të faturës dhe pagesës në vlerë 98,725€, ishin edhe dy pompa zhytëse në vlerë 4,000€ të cilat nuk ishin funksionalizuar ende. Ky pozicion i paraparë në kontratat, është pranuar nga menaxheri i kontratës, organi mbikëqyrës dhe çertifikuar/paguar sipas situacionit nr.4 për furnizim, transportim dhe montim të dy pompave zhytëse H=80m,Q=6.8 l/sek. Gjatë ekzaminimit të auditorit me prezencën edhe të organit mbikëqyrës të kontraktuar nga komuna, pompat nuk ishin montuar dhe nuk funksionin ende. Arsyetimi i organit mbikëqyrës ishte se për shkak të punimeve të pa përfunduara, montimi i tyre në aspektin fizik nuk ishte i sigurt; dhe
- Te kontrata “Furnizimi me material ndërtimor për raste emergjente” komuna ka pranuar faturën, dhe ka kryer pagesën në vlerë 4,000€ edhe pse sipas pozicioneve të materialit të faturuar nga OE, vlera e përgjithshme e pranimit të mallit ishte vetëm 2,198€ (sipas fletë pranimit). Situacioni është nënshkruar (nga menaxheri i kontratës dhe organi mbikëqyrës përgjegjës) dhe pagesa është çertifikuar për 1,802€ më shumë se sa mallrat e pranuar. Gjatë ekzaminimit në teren me prezencën edhe të organit mbikëqyrës, vërtetohet se mallrat e pranuar ishin në vlerë 2,198€.

## Rreziku

Mangësitë e identifikuara kanë rezultuar me:

- Planifikim jo të saktë të projekteve që mund të shkaktojnë kosto shtesë dhe krijon sfida buxhetore për komunën;
- Realizimi i projekteve jashtë planit mund të rrezikojë realizimin e projekteve të planifikuara dhe arritjen e objektivave të përcaktuara; dhe
- Pagesat e pozicioneve për punë të papërfunduara ose për artikuj të pa pranuar në baze të situacioneve dhe faturimeve të tyre, rrisin rrezikun që komuna të paguaj më shumë se sa sasia e pranuar.

<sup>7</sup> Ndërtimi i rrugës lokale në Vlashnje të Prizrenit: 183,837€; Renovimi i sallës së edukatës fizike në gjimnazin Gjon Buzuku: 249,441€; Rregullimi i ambientit turistik në Cvilen: 16,988€; dhe Ndërtimi i ambientit rreth lapidarit Besim Ndrecaj: 9,497€.

---

**Rekomandimi 10** Kryetari duhet të siguroj se projektet duhet të realizohen konform planeve dhe buxhetit. Në rastet kur shfaqet nevoja për ri destinim të mjeteve apo ndryshim të projekteve, duhet të ndiqen procedurat administrative të ri destinimit të mjeteve. Furnizimet dhe kryerja e punimeve duhet të mbikëqyren në vazhdimësi dhe pagesat të bëhen vetëm pasi të merret siguria e plotë se pozicionet e faturuara janë realizuar sipas paramasave dhe parallogarive, si dhe të forcoj masat e kontrollit që dështimet e tilla të mos përsëriten.

### Çështja 11 – Pagesat e gjobave i pasojë e vonesave në kryerjen e obligimeve

**E gjetura** Nga 600,000€ të ndara me ligjin e buxhetit për vitin 2017, për projektin “Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në Vlashnje”, komuna ka transferuar 593,290€ tek KRU Hidroregjioni Jugor sipas marrëveshjes, prej të cilave 387,078€ janë paguar gjobë, të shqiptuar nga OE për shkak të vonesave për kryerjen e obligimit me kohë, ndërsa pjesa tjetër prej 206,212€ kanë mbetur në xhirollogarinë e KRU Hidroregjionit Jugor si masë e nevojshme shtesë për sigurimin e projektit. Kostoja e këtij projekti sipas vlerësimit themelor ka qenë rreth 20.5 milion€, prej të cilave 12 milion€ do të financohet nga Banka Gjermane për Zhvillim (Kfw). Gjatë vitit 2016, financuesi gjerman, kishte njoftuar komunën për vonesat në zbatim të projektit dhe për shpenzimet shtesë (me më shumë se katër vite, pas nënshkrimit të marrëveshjes, shtator /2011). Sipas zyrtareve të komunës vonesat në shpronësim kanë ardhur si pasojë e mungesës së bordit të AKP-së.

Për më tepër nga 28 pagesat në vlerë prej 467,496€ të kryera direkt nga thesari në bazë të vendimeve gjyqësore dhe përmbaruesit privat, vetëm për shpenzimet administrative dhe shpenzime tjera përmbarimore janë paguar 41,937€. Një ndër arsytet e një dukurie të tillë ishte lidhja e kontratave me OE ende pa u siguruar fondet e nevojshme.

**Rreziku** Vonesat në zbatimin e marrëveshjeve si dhe kryerja e pagesave për gjoba nga kategoria e investimeve kapitale rrit rrezikun që mjetet e planifikuara të buxhetit aktual të mos shkojnë në të mirën e qytetareve.

**Rekomandimi 11** Kryetari i Komunës duhet të rrisë kontrollet në menaxhimin e projekteve kapitale. Fillimisht duhet të sigurohen fondet e nevojshme si dhe të gjitha parakushtet tjera për fillimin e projekteve, e më pas të zhvillohen procedurat tjera për kontraktimin me OE. Me tutje, të sigurojë kontrolle në monitorimin e punimeve deri në procesin e ekzekutimit të pagesave.

### 3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Për vitin fiskal 2017 janë planifikuar 229 aktivitete të prokurimit, nga të cilat janë nënshkruar 175 kontrata apo 80% e planit është realizuar. Në shtatë raste procedurat e prokurimit janë zhvilluar në vitin 2017, ndërsa kontratat janë nënshkruar në vitin 2018.

#### Çështja 12 – Planifikim dhe menaxhim i dobët i kontratave

**E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të vendos kontrolle të duhura në menaxhimin e kontratave si:

- Në dy procese të prokurimit “Rregullimi i ambientit turistik në Cvilen” në vlerë 16,987€ dhe “Riparimi i rrugës nga Restoranti Natyra deri tek Kalaja” në vlerë prej 6,900€, komuna kishte lidhur kontrata publike në mungesë të Projektit Ekzekutiv. Sipas nenit 28, pika 10, të LPP-së, Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit;
- Sipas rregullës financiare për shpenzimin e parasë publike asnjë kontratë publike nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të mjeteve. Në 10<sup>8</sup> raste kontratat janë nënshkruar pa zotim të mjaftueshëm të fondeve. Vlera totale e kontratave të nënshkruara ishte 3,641,742€, derisa zotimi i mjeteve për to ishte vetëm 287,000€ ose afërsisht 8%. Sipas zyrtarëve të komunës mos alokimi me kohë i të hyrave vetjake ka rezultuar me nënshkrim të kontratave pa zotim të plotë të mjeteve;
- Në dy<sup>9</sup> raste, menaxherët e projektit nuk kishin nënshkruar formularin e planit për menaxhimin e kontratës;

<sup>8</sup> “Ndërtimi i rrugës Smaq-Zojëz” në vlerë 159,365€, zotimi i mjeteve vetëm 10,000€; “Furnizim me material ndërtimi për familjet skamnore” 199,344€, zotimi 30,000€; “Furnizim me pelet për shkollat e Prizrenit” 91,154€, zotimi 10,000€; “Furnizim me karburante për Administratë Komunale” 303,991€, zotimi 2,000€, “Furnizim me material higjenik për QKMF” 40,600€, zotimi 3,000€; “Sigurimi fizik për QKMF” 45,000€, zotimi 1,000€, “Mbjellja e drunjëve dekorativ në Prizren” 1,223,210€ zotimi: 120,000.00€; “Intervenimi në infrastrukturë ku ka rrëshqitje të dheut” 1,145,800€, zotimi, 100,000€; “Ndërtimi i Rr. lokale në Vlashnje të Prizrenit” 183,837€, zotimi: 1,000€; dhe “Renovimi i sallës së edukatës fizike në gjimnazin Gj. Buzuku” 249,441€, zotimi:10,000€.

<sup>9</sup> “Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të Administratës Komunale në Prizren” dhe “Intervenimi në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore, rrëshqitja e dheut, përmbytjet dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit”.



- Kontrata për “Furnizim me naftë” tek kushtet veçanta thuhet që çmimi duhet të merret nga berza e lëshuar nga ana e organit të licencuar, si dhe OE është i obliguar që të siguroj berzën mujore (shuma e gjitha berzave ditore të pjesëtuara me numrin e ditëve të muajit paraparak). Në një rast komuna ka kryer pagesën në vlerë 1,246€ pa dëshmi se berza e ofruar është lëshuar nga organi i licencuar; dhe
- Komuna në dy raste për projektet “Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Krushë e Vogël, në vlerë 46,307€ dhe “Ndërtimi me elemente betoni i rrugëve lokale në fshatin Korishë” në vlerë prej 33,386€, kishte paguar situacionet përfundimtare pa sigurim të garancionit të punimeve për tri vite siç ishte kërkuar me kushtet e veçanta të kontratës. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtareve përgjegjës të menaxhimit të kontratës.

**Rreziku**

Mangësitë e identifikuar mund të rezultojnë me:

- Praktika e zhvillimit të procedurave në mungesë së hartimit të projektit ekzekutiv paraparakisht, mund të ndikoj që punimet e kryera tek projektet në fjalë mund të devijojnë nga kërkesa standarde e ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur;
- Hyrja në obligime pa fonde të zotuar rritë rrezikun që të mos mund të financohen në tërësi projektet dhe të rezultojë me dështim të kryerjes së tyre;
- Menaxhimi i dobët i kontratave mund të ndikojë në mos zbatimin e kontratave sipas kushteve kontraktuale, redukton efektivitetin në arritjen e objektivave dhe mund të rezultojë me vlerë të ulët për para dhe pagesa potencialisht të parregullta; dhe
- Mungesa e garancionit të punimeve mund të rezultojë humbje financiare për komunën për dëmtimet eventuale gjatë vitit të parë të shfrytëzimit të pasurisë.

**Rekomandimi 12** Kryetari të siguroj që zyra e prokurimit të mos filloj procedurat e prokurimit para se të përmbushen kriteret ligjore përkatësisht pa hartuar projektin ekzekutiv si dhe të siguroj kontrole të shtuara që para nënshkrimit të kontratave të bëhet zotimi i mjeteve. Me tutje të gjitha pagesat duhet të bëhen në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në kontratë.

---

### 13 - Shmangie nga procedurat e rregullta të prokurimit

**E gjetura** Në procesin e prokurimit "Furnizim me material ndërtimor për familjet skamnore" komuna kishte eliminuar nga gara OE i cili kishte ofertuar me çmimin më të lirë për arsyet se nuk kishte plotësuar dy kritere: "Projektet e ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit minimumi 370,000€" dhe "Pasqyrat financiare të kompanisë të shoqëruar me qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit". Pas ankesës së OE-së, OSHP-së ka vendosur që lënda të kthehet në rivlerësim sepse komuna ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 të LPP-së. Pas vendimit të OSHP-së, komisioni për vlerësim të tenderëve kishte shpallur përsëri të papërgjegjshëm OE më të lirë (edhe pse posedonte të gjitha dëshmitë) dhe kishte nënshkruar kontratë me OE e dytë me radhë në vlerë 199,344€ ose për 6,096€ më shumë se sa OE më i lirë.

Prej 350 procedurave të kryera në prokurim, në 220 raste apo 63% prej tyre, janë përdorur procedurat e kuotimit të çmimeve dhe atyre me vlerë minimale. Për "Dezinfektim, deratizim, dezinfektimin " në QKMF, është nënshkruar një kontratë (26.04.2017) në vlerë prej 3,971€, pastaj kontrata tjetër me procedura të hapura është nënshkruar (04.05.2017) në vlerë prej 34,016€, si dhe dy kontrata me vlera minimale. Ngjashëm ka ndodhë edhe me furnizimin me material zyrtar; furnizimi me inventar; furnizim me perde, ku për furnizime të njëjta ishin nënshkruar nga tri apo më shumë kontrata me vlera minimale.

**Rreziku** Praktika e tillë shton rrezikun e mos arritjes së vlerës për para, dëmtimit të reputacionin e komunës, dëmtimin e transparencën, eliminimin e konkurrencës dhe vejnë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/ produkteve të pranuar dhe përmbushjen e projekteve.

**Rekomandimi 13** Kryetari duhet të siguroj se kontrollet e vendosura janë funksionale gjatë vlerësimit dhe përzgjedhjes së operatorëve, aty ku ekziston mundësia të shqyrtoj në detaje rastet dhe të kërkojë sqarime shtesë. Me tutje te kërkojë një planifikim të hollësishëm dhe njësitë të vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim, si dhe të respektohen në plotësi LPP si dhe UA, në mënyrë që rastet e mësipërme të mos përsëriten.

### 3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Në memon tonë të planifikimit të auditimit, ishte identifikuar rreziku ku ka të bëjë me regjistrimin e pasurisë.

Vlera e tërësishme e pasurisë mbi 1,000€ ishte 477,093,646€, ndërsa ato nën 1,000€ ishin prezantuar në vlerën prej 946,658€. Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 2.1 Theksimi i çështjes të opinionit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare.

#### Çështja 14 - Dobësi në regjistrimin e pasurisë nën 1,000€- E-pasuria

**E gjetura** Neni 4.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare thekson se “Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare”. Komuna nuk ka procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë përkundër që ishte rekomandim në raportin e vitit të kaluar.

Regjistri i E-pasurisë nuk është i saktë për arsye se blerjet nga sektori i Shëndetësisë, Mirëqenie Sociale dhe QKMF nuk regjistrohen në këtë softuer, siç është paraparë në nenin 6, të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive financiare.

**Rreziku** Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejtë në pasqyrat financiare. Ndërsa, mangësitë në regjistrimin e plotë të pasurisë duke mos përfshirë të gjitha blerjet, vështirësojnë identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën, prejardhjen dhe pronësinë e tyre.

**Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013, si dhe të sigurojë se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Po ashtu të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-pasuria në të gjitha dikasteret komunale.

### 3.10 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

#### Çështja 15 - Depozitimi i vonuar i parasë së arkëtuar

**E gjetura** Bazuar në Rregullën Financiare 03/2010 Neni 11, komuna obligohet që arkëtimin e të hyrave në para të gatshme (deri në 10€) në fund të çdo dite, t'i depozitojë në bankë në shumën totale shoqëruar me një dokument përmbledhës që përmban "UNIREF" dhe numrin e verifikimit. Shuma prej 365€, e grumbulluar me datë 20.02.2017 (për çertifikata të lindjes dhe të hyrave tjera) nuk janë deponuar deri me 04.04.2017, me 42 ditë vonesë. Gjithashtu shuma prej 1,178€ që i përket të hyrave nga shëndetësia ishin deponuar me datën 07.02.2017. Këto të hyra ishin grumbullim i parave në QKMF që nga muaji dhjetor 2016 që d.m.th. ka vonesa në deponim për afër 45 ditë.

**Rreziku** Depozitimi i vonuar i parasë së grumbulluar në arka rritë rrezikun e keqpërdorimit të parasë publike. Gjithashtu kjo shpie të raportimi jo i drejtë i periudhës kohore të grumbullimit të të hyrave përkatëse, dhe përveç kësaj, një praktikë e tillë nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

**Rekomandimi 15** Kryetari duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se depozitat e përditshme të parasë bëhen në fund të çdo dite në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### 3.11 Të arkëtueshmet

Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 17,063,000€. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me tatimin në pronë, në vlerë 7,238,000€, taksa në firmë 6,330,000€, nga mbledhja e mbeturinave 2,341,000€, etj. Në përgjithësi vlera e LLA është rritur në krahasim me vitin e kaluar për 1,495,000€.

#### Çështja 16 - Rritja e të arkëtueshmeve

**E gjetura** Komuna nuk kishte nxjerr dhe aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e të arkëtueshmeve nga vitet paraprake, në veçanti tek të hyrat nga menaxhimi i mbeturinave të cilat ishin rritur rreth 667,000€ dhe taksat në firmë 576,000€.

**Rreziku** Mungesa e mekanizmave ka rezultuar me vlerë të lartë të të arkëtueshmeve e cila mund të ndikojë në vështirësimin në mbledhjen e tyre për shkak të vjetërsimit, si dhe mos përmbushjen e planit të shpenzimeve.

**Rekomandimi 16** Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

### 3.12 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve nga 1,383,866€ sa ishin në fund të vitit 2016 kanë shënuar rritje në 3,294,000€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Kjo vlerë e obligimeve të papaguara është rezultat i kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme dhe hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

#### Çështja 17 - Niveli i lartë i obligimeve dhe rritja e detyrimeve kontingjente

Komuna nuk ka arritur të krijoj një sistem të evidentimit dhe menaxhimit të faturave të pranuar nga operatorët ekonomik-nga pranimit dhe deri të pagesa e tyre. Sipas Rregullës Financiare 01-2013, MF- Shpenzimi i parave publike Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Katër<sup>10</sup> pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar me vonesë nga 13 deri 151 ditë. Për më tepër, ne kemi identifikuar tri<sup>11</sup> fatura (obligime të vitit 2017) të paguara në vitin 2018 në vlerë totale 334,518€ nuk ishin shpalosur në PFV. Sipas Zyrtarit Kryesor Financiar ka ndodhur sepse faturat nuk ishin raportuar nga drejtoria përkatëse. Përpos detyrimeve të rregullta, komuna përballlet edhe me detyrime kontingjente të cilat në fund të vitit 2017 kanë vlerën 1,225,000€.

**Rreziku** Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të përballlet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat në pagesa.

**Rekomandimi 17** Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas pranimit të faturës. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre. Për detyrimet e viteve paraprake duhet të përcaktojë një plan shtesë për pagesën e tyre e cili duhet të përfundohet para përfundimit të vitit 2018.

<sup>10</sup> Pagesa në vlerë 47,732€ "Dru" tri fatura në vlerë 15,428€ ishin paguar me vonesë 16, 30 dhe 57 ditë; Pagesa në vlerë 19,040€ "Dru" dy fatura në vlerë 8,046€ ishin paguar me vonesë 13 dhe 57 ditë; Pagesa në vlerë 9,442€ "Shërbime Postare" ishte paguar me 151 ditë vonesë; dhe Pagesa në vlerë 5,563€ "Furnizim i zyrës" me 30 ditë vonesë.

<sup>11</sup> Pagesat Nr. 62218010 neni 39.2 në vlerë 137,974€; Nr. 622180034 Intervenim në infrastrukturë në raste fatkeqësie natyrore në vlerë 77,113€ si dhe Nr. 622180034 Intervenim në infrastrukturë në raste fatkeqësie natyrore në vlerë 129,431€.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 ka rezultuar në 16 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, gjashtë ishin në proces dhe 10 nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 15 rekomandime (10 të pa zbatuara dhe pesë në zbatim e sipër). Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

### Çështja 18 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

**E gjetura** Komuna, ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i tyre monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen. Si pasojë dobësitë e prezantuara në raportet e viteve paraprake ende janë evidente, si

- Keq-klasifikimi i shpenzimeve si dhe dobësitë në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë;
- Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ dhe vlera e dobët për para në prokurim
- Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ për shqyrtimin e rritjes së realizimit të të hyrave; dhe
- Vonesa në kryerjen e obligimeve ndaj operatorëve ekonomike, dhe hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme, në veçanti rritjen e-norme brenda një viti të detyrimeve kontingjente.

**Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontroleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

**Rekomandimi 18** Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

---

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimit të rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorit të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë, ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, zhvillimi mbi proceset e menaxhimit të rrezikut, menaxhimi i projekteve kapitale dhe pasurisë komunale, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Për shumicën e aktiviteteve komunale ka një komunikim dhe raportim të mirë mes bartësve të njëjësive dhe kryetarit, të përcjella me procesverbale, por mungon monitorimi strategjik, si dhe nuk ka një raportim formal dhe sistematik (monitorim) që i ndërlidh objektivat e komunës me rezultatet.

Komuna edhe pse kishte formuar ekipin për hartimin e planit strategjik edhe me tej nuk e kishte hartuar planin strategjik dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Përveç Planit strategjik, kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës sipas të cilit ka planifikuar nëntë auditime, nga të cilat tetë ishin finalizuar gjatë vitit 2017.

NjAB kishte bërë një punë të mirë duke audituar fusha me rrezik të lartë, siç janë: procedurat e prokurimit, rekrutimin, të hyrat dhe shpenzimet.

## Çështja 19 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së

**E gjetura** Në tetë raportet e përfunduara, NjAB-të kishin dhënë 23 rekomandime për të përmirësuar funksionimin e kontrollit të brendshëm në komunë. Pjesa më e madhe e rekomandimeve ishin zbatuar pjesërisht. Për me tepër zbatimi i rekomandimeve të dhëna edhe për vitin 2016 nuk ishte në nivelin e duhur. Nga 43 rekomandime, vetëm 13 janë zbatuar dhe 12 ishin në proces të zbatimit. Për me tepër një numër i drejtorive të audituara nuk kanë përgatitur plane të veprimit.

Komiteti i Auditimit (KA) gjatë vitit 2017 kishte mbajtur vetëm dy takime pune. Në bazë të procesverbaleve vërehet që janë trajtuar dobësitë dhe rreziqet e raportuara nga NjAB-i. Mirëpo kontributi i KA-së në aspektin e përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve tek menaxhmenti dhe përmirësimit të proceseve dhe kontrolleve të brendshme ishte mjaftë simbolik.

**Rreziku** Dështimi për të adresuar rekomandimet e auditimit rrisin rrezikun që dobësitë e identifikuara nga auditimi të mbesin të pa përmirësuara dhe potencialisht mund të rezultojnë humbje financiare për komunën dhe vlerë të dobët për para. Mungesa e angazhimit të komitetit të auditimit për ta shtyrë adresimin e rekomandimeve rritë rrezikun që mangësitë të përsëriten vazhdimisht.

**Rekomandimi 19** Kryetari duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku janë identifikuar dobësitë. Komiteti i Auditimit duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm dhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.



---

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë kërkesat për vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në procedurat e MFK-së kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

---

## Çështja 20 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo efektiv financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Si të tilla aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes, kërkojnë përmirësim. Ne kemi identifikuar se kontrollet mbi të hyrat akoma nuk janë mjaft efektive, dhe ka mangësi në kontrolle në disa fusha të shpenzimeve.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive.

**Rreziku** Mos azhurnimi i raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.

**Rekomandimi 20** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

---

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në theksim të çështjes për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve si dhe për mos regjistrim të plotë të pasurisë. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet që mund të ndikojnë në opinionin e auditimit, respektivisht të regjistrohen saktë të gjitha pasuritë kapitale.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar dhe do të zbatohet në mënyrë rigoroze Plani i veprimit me aktivitetet specifike dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, duke i përcaktuar qartë edhe afatet kohore brenda të cilave rekomandimet duhet të zbatohen. Në fokus parësor të trajtimit duhet të jenë rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.		Komuna ha hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo pavarësisht kësaj një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve kanë mbetur të pazbatuara.	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit, si dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin.			Nuk janë marrë masa.

2.5.2 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet sa më parë të miratoj një strategji të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, ku do të përcaktohet qartë qasja e menaxhmentit për reagime ndaj rreziqeve. Krahas identifikimit të rreziqeve në nivel operativ dhe strategjik, menaxhmenti duhet të hartoj edhe një plan veprimi ku përcaktohen masat e veprimit për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme.			Nuk janë marrë masa.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.			Nuk janë marrë masa.
2.5.3 Plani strategjik i Komunës	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për Komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.			Nuk janë marrë masa.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë arsyet për veprimet e limituara, të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të koordinoj bashkëpunimin me Komitetin e Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm.		Niveli i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së ende ishte i ulët. Po ashtu KA nuk ka qenë plotësisht funksional.	

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj një shqyrtim të hollësishëm të të gjitha rasteve të përmendura më lartë për të analizuar pse kërkesat ligjore dhe rregullat e prokurimit nuk janë zbatuar, dhe pas shqyrtimit të rasteve, të merren masat e duhura. Gjithashtu, duhet vlerësuar pse kontrollet e certifikimit kanë dështuar në parandalimin e pagesave të parregullta, siç ishte rasti me pagesat e derivateve.		Kemi vërejtur se nuk kemi raste të tejkalimit të vlerës së kontratës, sigurimi i garancionit të punimeve në përputhje me ligjin.	
3.4 Shpenzimet jo përmes prokurimi	Kryetari duhet të kryej një rishikim të Kompensimeve/ pagesave për komisione si dhe marrëveshjeve me institucionet tjera në mënyrë që të vërtetohet arsyeshmëria e tyre dhe të jetë në harmoni me ligjet e aplikueshme për të shmangur pagesat e pa arsyeshme.	Po.		
3.4 Pagesat pa procedura të prokurimit	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuara për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitim të tyre në të ardhmen. Kryetari duhet të konsiderojë mundësinë e kontraktimit të një pako të vetme të shërbimeve të telefonisë mobile. Kjo do të siguronte çmime më të volitshme dhe do të ulte koston e shërbimeve telefonike.	Po.		

3.4.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të siguroj që kontratat të nënshkruhen mbi bazën e kriterëve të qarta në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe konkurrues dhe të sigurohen paraprakisht kontratat e punës. Kontratat duhet të specifikojnë saktë shumën mujore dhe pagesat e pagave të jenë në harmoni më kontratat. Zyrtarët e personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës. Kompensimi për mbajtjen e mësimin jo formal të bëhet në përputhje me rregulloren.	Po.		
3.4.2 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të rishikojë rastet e identifikuar për të siguruar që kontrollet në këtë fushë janë aplikuar sipas kërkesave, për të siguruar që mjetet janë përdorur për qëllimin e planifikuar dhe në pajtim me rregulloret.	Po.		
3.5 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari i Komunës duhet të siguroj një proces të harmonizimeve të rregullta mujore ndërmjet drejtorive Komonale dhe administratës së financave, si dhe të vendos kontrole të qëndrueshme që sigurojnë një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv të të hyrave vetjake të Komunës.			Nuk janë marrë masa.
3.5.1 Të hyrat nga sektori i mbeturinave	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta të mos inkasimit të të hyrave nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e Komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të bëhen barazimet me OE dhe të mos kryhen pagesat ndaj atyre që kanë borxhe ndaj Komunës.			Nuk janë marrë masa.



3.5.2 Dobësi në kontratat e koncesioneve dhe qiradhënies	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunes.			Nuk janë marrë masa.
3.5.3 Fituesi i ofertës për shfrytëzimin e lokaleve afariste me çmim me të ulët	Kryetari duhet të siguroj që me rastin e shpalljes së ankandëve publike, pjesëmarrësit paraprakisht të kushtëzohen më sanksione nëse tërhiqen pas hapjes së ankandit publik dhe të respektoj Rregulloren për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike përmes ankandit publik.	Po.		
3.6 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të rishikojë pse pasuritë e identifikuar nuk janë regjistruar në sistemin e-Pasuria, dhe të adresojë dobësitë që kanë të bëjnë me azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrimit të pasurisë. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi.			Nuk janë marrë masa.
3.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari të shqyrtojë ngritjen e një grupi pune të veçantë për shqyrtimin e realizimit të inkasimit të borxheve, në veçanti rritjen enorme brenda një viti të llogarive të arkëtueshme nga shërbimet për mbledhje të mbeturinave. Gjithashtu, të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve, si dhe të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë edhe veprimet ligjore.			Nuk janë marrë masa.

3.6.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të Komunës, duhet të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, për të evituar rrethanat të cilat mund shkaktojnë pagesën e tyre drejtpërdrejt nga MF apo edhe sipas vendimeve gjyqësore.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes dhe të vendos procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha dobësitë që ndërlidhen me PFV.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim, edhe më tutje kanë probleme me keq-klasifikimin e shpenzimeve si dhe me shpalosjet, përfshirë pasurinë dhe detyrimet.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse rekomandimet e auditimit nuk po zbatohen dhe të vendos masa përgjegjësie ndaj të gjithë personave të ngarkuar me plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve. Pas finalizimit të këtij raporti, Kryetari duhet të përgatit Planin e veprimit me afate dhe aktivitete të qarta, dhe të përcaktoj personat përgjegjës për zbatimin në tërësi të këtij plani.		Komuna ha hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo pavarësisht kësaj një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve kanë mbetur të pazbatuara.	
2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.			Nuk janë marrë masa.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën duke përfshirë koston e strategjisë, të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore. Të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.			Nuk janë marrë masa.
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme për këtë. Po ashtu, të merr masa që raportimet nga ana e ZKF-së të bëhen sipas kërkesave ligjore për progresin fizik të investimeve kapitale.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.		Nuk janë marrë masa për gjetjen e formës dhe metodës për implementimin e rekomandimeve. Komiteti i Auditimit është themeluar por edhe gjatë këtij viti ka qenë jo funksional për gjetjen e mënyrës për implementimin e rekomandimeve.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marrë masa.

3.1.1 Të hyrat(Tatimi në pronë)	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme. Gjithashtu, veprime shtesë duhet të ndërmerren për të siguruar se zbritjet për 10,000€ aplikohen në pajtim me nenin 9 të ligjit mbi tatimin në pronë.			Nuk janë marrë masa.
Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale	Kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandëve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale në mënyrë që të ketë një proces të hapur dhe transparent, si dhe të ushtroj monitorim të vazhdueshëm tek shfrytëzimi i hapësirave publike në mënyrë që të mos shfrytëzohen pronat komunale pa kryer paraprakisht obligimet sipas kontratave të lidhura. Duhet vendosur edhe mekanizmat që pronat të mos shfrytëzohen pa pasur paraprakisht kontratë valide, të nënshkruar me komunën.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të shqyrtojë arsyet se pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, dhe të ushtrojë më shumë kontrole për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten, si dhe të gjitha faturat në momentin e pranimit, së pari të protokollohen dhe pastaj të procedohen më tutje për pagesë.		Pjesërisht ishte zbatuar, pasi edhe këtë vit kemi hasur në pagesa pa procedura të prokurimit. Sa i përket protokollimit të faturave është zbatuar rekomandimi.	
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit përgatit dosjet e tenderit sipas kërkesave të LPP dhe specifikon qartë sasitë e përafërta indikative të punëve ose vlerën e parashikuar të kontratës. Po ashtu, të mos iniciohen aktivitete të prokurimit pa hartimin e projekteve ekzekutive.		Pjesërisht ishte zbatuar, pasi që kemi konstatuar se në disa raste iniciohen aktivitete të prokurimit pa hartimin e projekteve ekzekutive.	

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare do ta kryej punën në pajtim me rregulloren, duke përfshinë dhe vlerësuar gjithë pasurinë e komunës.			Nuk janë marrë masa.
Mosfunksionimi i sistemit të E-Pasurisë -	Kryetari duhet që të rekrutoj zyrtarin pranues/logjistikës në një afat sa më të shkurtër në mënyrë që sistemi i e-pasurisë të funksionalizohet plotësisht dhe evidencat e pasurisë të azhurnohen.		Zyrtari i pasurisë ishte rekrutuar por edhe me tej nuk ishte në funksion të detyrës.	
Mungesa e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë	Kryetari duhet që të bëj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të shqyrtojë ngritjen e një grupi pune të veçantë për shqyrtimin e realizimit të inkasimit të borxheve. Të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerrë shkaktarët e dështimit në pagesën e borxheve, si dhe të shfrytëzojë të gjitha mjetet në dispozicion, duke mos përjashtuar as masat administrative dhe veprimet ligjore.			Nuk janë marrë masa.
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që të gjitha faturat të raportohen drejtë në Ministri të Financave në pajtim me Rregullën e Thesarit 04/2011-Për raportimin e obligimeve të papaguara, në mënyrë që kjo të reflektoj edhe me prezantim të drejt të obligimeve në PVF.			Nuk janë marrë masa.

## Shtojca III: Letër konfirmim



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës / Председник Општине  
Belediye Başkanı

01 Nr. 47/18 Dt. 06.06.2018



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Beledijesi

DATË:	06.06.2018
REFERENCE:	
PËR:	Valbon Bytyqi, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm
CC:	Luljeta Morina, Udhëheqëse e departamentit të auditimit  Kapllan Muhaxheri, Udhëheqës i ekipit
NGA:	Prof.dr. Mytahir Haskuka Kryetar i Komunës së Prizrenit
LËNDA/TEMA	<b>LETËR E KONFIRMIMIT</b> - Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së **Prizrenit**, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dh
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre

Me respekt!